


**SPORT KLUB BESA SHA
ME SELI NE KAVAJE**



**VENDIM N.1
I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE
SHOQERISE SPORT KLUB BESA SHA**

Sot me date 31.01.2002, ne Tirane, n epranine e noterit, mbahet mbledhja e jashtezakonshme e ortakeve te shoqerise SPORT KLUB BESA SHA per te diskutuar mbi kete rend dite:

- Shitja e aksioneve
- Ndryshime ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise

Jane te pranishem te gjithë ortaket e shoqerise qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise dhe saktesisht:

1. **ENGJELL BURIMI**, i biri Bashkimit dhe i Drites, lindur ne Tirane me 05.07.1955 dhe banues ne Tirane me adrese: Njesia Nr. 5 Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Apartamenti 7/1, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr.Pas.
2. **SHPETIM BIZHDILI**, i biri i Banushit dhe i Qerimes i lindur ne Kavaje me 26.10.1963 dhe banues ne Kavaje me adrese: Lagjia Nr. 5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr.Pasaporte 0001052 .
3. **BASHKIA KAVAJE** Perfaqesuar nga Kryetari i saj Z. Islam VELIU, i biri i Brahimit i datelindjes 16.12.1953, lindur dhe banues ne Kavaje, ne Lagjen nr 5, RR."Kajo Karafili".

Ortaket e mesiperm perfaqesojne :

- a) Engjell Burimi - 34% te kapitalit te shoqerise.
- b) Z. Shpetim Bizhdili - 33% te kapitalit.
- c) Bashkia Kavaje - 33% te kapitalit.

100% te kapitalit te shoqerise.

Mbledhja eshte lajmeruar qe para 15 ditesh dhe te gjithë ortaket kane dijen per rendin e dites. Pas diskutimeve, me unanimitet

U VENDOS

- Ortaku Engjell Burimi i shet aksionet e tij prej 34% te kapitalit te shoqerise ortakut Shpetim Bizhdili me vleren 680.000 leke. Ortaku Engjell Burimi fergohet nga shoqeria dhe ortaku Shpetim Bizhdili behet ortak me 67% te aksioneve me vleren 1.340.000 leke.
- Ndryshimi i perberjes se Keshillit Mbikqyres. Z. Agron Harizi, Islam Veliu dhe Fatmir Efica japin doreheqjen nga keshilli mbikqyres. Emerohen si anetare te keshillit Mbikqyres zoterinjte: Abaz Trimi, Islam Veliu dhe Shaban Myftiu.
- Z. Engjell Burimi shkarkohet nga detyra e Drejtorit dhe Presidentit te shoqerise dhe Z. Shpetim Bizhdili emerohet ne detyren e Drejtorit dhe Presidentit te SPORT KLUB BESA SHA.

Sa me siper nenshkruhet nga palet ne prani te noterit:

ENGJELL BURIMI

SHPETIM BIZHDILI

BASHKIA KAVAJE

KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me 31/01/2002, ndermjet te nenshkruarve

Nga njera ane:

- 1. Z. ENGJELL BURIMI**, i biri Bashkimit dhe i Drites, lindur ne Tirane, me 05.07.1955 dhe banues ne Tirane me adrese: Njesia Nr. 5 Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Apartamenti 7/1, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr.Pas.

Qe tani e tutje ne kete akt do te kete emertimin "pala shiteses"

- 2. SHPETIM BIZHDILI**, i biri i Banushit dhe i Qerimes i lindur ne Kavaje me 26.10.1963 dhe banues ne Kavaje me adrese: Lagjia Nr. 5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr.Pasaporte 0001052 .

Qe tani e tutje ne kete akt do te kete emertimin "pala blerese".

1) Pala shiteses impenjohet ti shese pales blerese, qe nga ana e vet impenjohet te bleje, pasurite e pershkruara me poshte:

2) **PERSHKRIMI**: Ne baze te vendimit nr. 26887 date 21.12.2001, leshuar nga Gjykata e Rrethit Tirane eshte themeluar shoqeria aksionere "S.K.BESA" Sh.A me seli ne Kavaje. Rezulton se ortakët aksionere te shoqerise se siperpermendur jane si me poshte vijon:

- a) Engjell Burimi - 34% te kapitalit te shoqerise.
- b) Z. Shpetim Bizhdili - 33% te kapitalit.
- c) Bashkia Kavaje - 33% te kapitalit.

100% te kapitalit te shoqerise

Kapitali i shoqerise ka nje vlere nominale prej 2.000.000 Leke.

Objekti i ketij akti eshte shitja e aksioneve te ortakut Engjell Burimi si pale shiteses, per nje total prej 34% te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 680.000 leke te Shpetim Bizhdili si pala blerese e cila nga ana e vet pranon te bleje keto aksione, si me poshte vijon:

3-ÇMIMI: Çmimi eshte vene me marreveshje dypaleshe ne masen 680.000 leke te pagueshme cash.

4-GARANCITE: Pala shiteses garanton deri tani rrezikun e abuzimit, duke deklaruar se aksionet jane ne pronesi te saj eskuzive, te lira dhe pa asnje barre apo probleme gjyqesore.



5-KALIMI I PRONESISE: Saktësohet se pronesia transferohet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakeve të shoqërisë S..BESA SHA dhe me depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit të Tiranës. Me nënshkrimin e kontratës së shitjeve të aksioneve, raportet në shoqërinë SPORT KLUB BESA SHA janë si vijon:

- 1- Shpetim Bizhdili
- 2- Bashkia Kavaje

67% të aksioneve me vlerë 1.340.000 leke
33% të aksioneve me vlerë 660.000 leke

100% të aksioneve me vlerë 2.000.000 leke

6-SHPENZIMET DHE TATIMET: Vetëm shpenzimet notoriale dhe taksat e duhura për transferimin e pronësive do të jenë në ngarkim të palës blerëse; mbeten në ngarkim të palës shitëse vetëm tatimet që nuk kanë lidhje me blerësin.

Rene dakord dhe firmosur në Tiranë, më 31.01.2002

PALET:

SHPETIM BIZHDILI



ENGJELL BURIMI

